



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS**



FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
Tel/Fax +35542369987. www.fhf.edu.al
Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë

Tiranë, më 25.11.2014

Nr. _____ Prot.

Rregullore
“Mbi ndalimin e konsumit të duhanit në ambientet e
Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë”

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr.9636 datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit”, ndryshuar me Ligjin 76/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9636 datë 06.11.2006”, në kuadrin e parandalimit të pasojave të dëmshme që sjell duhani në shëndetin e njeriut, sidomos konsumuesit pasiv si dhe mbrojtjen e ambienteve të punës dhe auditorëve të mësimit brenda Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë miratohet kjo rregullore e cila,

VENDOSI:

NENI 1

Ndalohet konsumi i duhanit në të gjitha ambientet e Fakultetit si:

- Zyra
- Auditore
- Laboratore
- Korridore
- Shkallë
- Tualete
- Mjediset e përbashkëta të qarkullimit brenda godinës

- Vende të tjera brenda këtij institucioni, duke vendosur shenja paralajmëruese me mbishkrimin “NDALOHET DUHANI”, në vende ku mund të lexohen edhe nga distanca deri në 5m.

NENI 2

Në faqen zyrtare të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, në monitoret e njoftimeve në hollin e fakultetit, si dhe në këndin e njoftimeve do të publikohet në mënyrë të dukshme një mesazh informues për ndikimin që ka pirja e duhanit në shëndet dhe rreziqet nga produktet e duhanit. Për përmbushjen e këtij detyrimi ngarkohet Dega e IT-së dhe e Menaxhimit.

NENI 3

Për studentët dhe punonjësit të cilët e konsumojnë duhanin caktohen hapësirat, jashtë objektit (fakultetit), 3m në distancë nga muret e fakultetit e cila do të përdoret ekskluzivisht si vendi ku do të konsumohet duhani në fakultet.

NENI 4

Për të gjithë studentët dhe punonjësit, të cilët do të identifikohen duke konsumuar duhan në vende të përcaktuara sipas nenit 1 do të ndërmerren masa në zbatim të nenit 16 të Ligjit 9636 datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit”, i ndryshuar, ku janë të përcaktuara sanksionet me gjobë dhe do të ndërmerren masa disiplinore për personat që nuk zbatojnë këtë rregullore.

NENI 5

Me qëllim zbatimin rigoroz të ligjit antiduhan dhe kësaj rregullore detyrohen të gjithë punonjësit që identifikojnë persona (studentë dhe punonjës) të cilët konsumojnë duhanin brenda Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, të lajmërojnë personin përgjegjës në mënyrë që të merren masat e nevojshme.

NENI 6

Personi përgjegjës për zbatimin e kësaj rregullore është Kryetari i Degës së Burimeve Njerëzore dhe Menaxhimit të Përditshëm.

Personi përgjegjës është i detyruar të merret me vendosjen e shenjave të dukshme, të cilat demonstrojnë se pirja e duhanit në këto mjedise ndalohet si dhe të mundësojë heqjen dhe mos lejimin e taketukeve të cigareve.

NENI 7

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

K A N C E L A R

PARASHQEVI POGAÇE